Kultivonin kanabis, arrestohen tre persona në Bulqizë, sekuestrohen 2 armë gjahu

21 Korrik, 2025 15:29



Madhësia e tekstit:

BULQIZË

Finalizohet pas një hetimi 2-mujor me metoda proaktive, operacioni policor antikanabis i koduar "Gracka", kundër kultivimit të bimëve narkotike.

Vihen në pranga 3 shtetas që ushtronin veprimtarinë kriminale të kultivimit të bimëve narkotike.

Sekuestrohen 2 armë gjahu që u gjetën në banesën e njërit prej shtetasve të arrestuar, të cilat i përdorte dhe për rrajtjen e miniserës ku kishin kultivuar lëndën narkotike.

Në zbatim të detyrave të përcaktuara në planin operacional mbarëkombëtar, të hartuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, për intensifikimin e kontrolleve, me shërbime të shtuara dhe logjistikë bashkëkohore, me qëllim parandalimim dhe goditjen e tentativave të kultivimit të bimëve narkotike, si rezultat i kontrollit të territorit, shërbimet e Komisariatit të Policisë Bulqizë, në një zonë të pyllëzuar të fshatit Golevisht, kanë konstatuar një miniserë brenda së cilës dyshohej se kultivoheshin bimë narkotike.

Më pas, shërbimet e Policisë e kanë mbajtur në kontroll këtë zonë dhe kanë referuar materialet në Prokurori, e cila regjistroi procedimin penal.

Në vijim të hetimeve me metoda proaktive janë siguruar prova ligjore për tre shtetas të cilët kishin kultivuar bimë narkotike në një miniserë dhe më pas do t'i transportonin në pyll, me kafshë pune, me qëllim mbjelljen e tyre në tokë.

Pas sigurimit të provave, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër ka lëshuar urdhrat e ndalimit për 3 shtetas, të cilat janë ekzekutuar menjëherë nga shërbimet e Policisë. Konkretisht janë ndaluar shtetasit:

A. C., 52 vjeç, banues në Peshkopi;
A. C., 30 vjeç dhe E. L., 34 vjeç, të dy banues në fshatin Viçisht, Bulqizë.

Nga hetimi proaktiv rezultoi se këta shtetas kishin kultivuar në një miniserë, dhjetëra bimë narkotike, të cilat më pas kanë tentuar t'i transportojnë me kafshë pune, në pyll, me qëllim mbjelljen e tyre në tokë.

Gjithashtu, shërbimet e Policisë kanë ushtruar kontroll në banesën e shtetasit A. C., ku janë gjetur dhe sekuestruar 2 armë gjahu që ai i mbante pa leje.

Vijon puna për identifikimin dhe kapjen e shtetasve të tjerë të implikuar në këtë veprimtari kriminale.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, për veprime të mëtejshme.

Për t'u bërë pjesë e grupit "**Balkanweb**" mjafton të klikoni: Join Group dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. Grupi Balkanweb

Etiketa: bulqizë kanabis

TË NGJASHME

Në arrest shtëpia, por 26-vjeçari nuk heq dorë, kapet duke shpërndarë kanabis te "Vollga". Në pranga dhe bashkëpunëtori
21 Korrik, 2025

Konflikti në Bulqizë, plagosi me thikë 27-vjeçarin, arrestohet autori
21 Korrik, 2025

Taboola Feed

You will never turn off your computer again. No Install. Play for free.
PowerQuest · Sponsored

Play this game for 1 minute and see why everyone is addicted.
No Installation. Play for free.
Navy Quest · Sponsored


Nevina Shtylla përballet me një moment të sikletshëm, ja çfarë i ndodh moderatores gjatë emisionit
Nevina Shtylla përballet me një moment të sikletshëm, ja çfarë i ndodh moderatores gjatë emisionit
balkanweb.com

Most Computer Owners Don't Know This. Do It Today!
This Could Be the Most Important Tip You Read This Year
Outlyte Driver Updater · Sponsored
Click Here

TË FUNDIT NGA -KRONIKË

ANALIZA E BIRN/ Fondet e BE-së për bujqësinë, si i ndi hetimet Zyra Europiane kundër Mashtrimit mbi bazën e ankesave dhe denoncimeve të marra nga Shqipëria
21 Korrik, 2025

Policia Rrugore e Elbasanit kontrolle intensive, qindra gjoba, arrestohet një shofer
21 Korrik, 2025

Beleri kërkoi krimë, por humbi 'betejën e fundit', Gjykata e Lartë e lë në burg
21 Korrik, 2025

"Dua 2 mijë euro"/ Oficeri i policisë gjykojnë i kërkoi para të riut që ta mënjanë nga burgu; Kërkoi që shuma të derdhej brenda disa dite dhe...
21 Korrik, 2025

Panik në Sarandë, bie zjarr në tatë e energjisë, kabllot shkëputen e blen përtokë
21 Korrik, 2025

Ryshfet për të mos u vënë gjobë farmacine, SPAK çon për gjykim 3 zyrtarë të Agjencisë së Barnave
21 Korrik, 2025

KATEGORIA VIDEO

Në arrest shtëpia, por 26-vjeçari nuk heq dorë, kapet duke shpërndarë kanabis te "Vollga". Në pranga dhe bashkëpunëtori
21 Korrik, 2025

"Qeshurake qirazi e Akuadromit të Tiranës", Tahiri: Ka një e ulët vlera e pronës, aq më i lartë pazari për Veliajn
21 Korrik, 2025

Kultivonin kanabis, arrestohen tre persona në Bulqizë, sekuestrohen 2 armë gjahu
21 Korrik, 2025

Zbardhet takimi me presidentin, studentët e njësikësuë: Nëse fjalë nuk arrëdhet, bojkotojmë mësimin
21 Korrik, 2025

Panik në Sarandë, bie zjarr në tatë e energjisë, kabllot shkëputen e blen përtokë
21 Korrik, 2025

© 2025 BalkanWeb. Të gjitha të drejtat e rezervuara.